



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	23.02.2025
Nr.	1231 prot.

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator

E nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni se janë përgatitur projektvendimet si vijon:

1. Projektvendim "Për rregullat për numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë, dokumentacionin përkatës, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit".
2. Projektvendim "Për përdorimin e pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025".
3. Projektvendim "Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".

Propozoj thirrjen e mbledhjes së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtyre projektvendimeve.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimeve dhe relacioneve shoqëruese.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 3 vjet
Konceptoi:
A.Agolli
B.Kodra
P.Doçaj
A.Lamçe
M.Çelmeta

